



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 03.09.2014 ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Projektligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar”.
3. Projektligji “Për të drejtën e informimit”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Armando Subashi, Blendi Klosi, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Petrit Vasili, Dashamir Peza, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pirro Lutaj, Vexhi Muçmataj, Spartak Braho, Silva Caka, Tom Doshi dhe Mark Frroku,

Mungojnë:

Edi Paloka, Kastriot Islami, Pandeli Majko, Oerd Bylykbashi, Fatmir Mediu, Arben Ristani, Gjovalin Bzheta, Nard Ndoka, Mhill Fufi, Keltis Kruja, Gent Strazimiri, Eduard Halimi dhe Tahir Muhedini.

Të ftuar:

Arben Isaraj – zëvendësministër i Drejtësisë

Edlira Jorgaqi – drejtore e Komunikimit

Katrin Treska – drejtore në Ministrinë e Drejtësisë

Etilda Gjonaj (Saliu) – komisionere te Avokati i Popullit

Arben Shkëmbi – komisioner te Avokati i Popullit

Andi Bala – këshilltar te Avokati i Popullit

Anola Shala – drejtore për Çështjet Ligjore te Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave
Personale

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Meqë kuorumi i nevojshëm për hapjen e mbledhjes së Komisionit është realizuar, mund të fillojmë sipas rendit të ditës, i cili ka dy projektligje të rëndësishme që janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën. Së pari, është projektligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe, së dyti, projektligji “Për të drejtën e informimit”.

Për të paraqitur të dyja projektligjet, nga qeveria është i pranishëm zoti Arben Isaraj, zëvendësministër i Drejtësisë.

Fillimisht, të dëgjojmë zotin Isaraj, për një përmbledhje të shkurtër të projekteve. Meqë kemi shqyrtim në parim, besoj se edhe zoti Isaraj do të ndajë të njëjtin mendim, të bëjë një përmbledhje të të dy projekteve, për shkak se kanë natyra të njëjta.

Pastaj të dëgjojmë relatoren, zonjën Caka, për projektligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe pyetjet e mundshme.

Pastaj dëgjojmë relatoren për projektligjin “Për të drejtën e informimit”, zonjën Hysi.

Pastaj, përfaqësuesit e Zyrës së Avokatit të Popullit dhe Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nëse janë të pranishëm, pasi janë ftuar të marrin pjesë, edhe me kërkesën e tyre.

Fillimisht, të dëgjojmë zotin Isaraj.

Arben Isaraj – Zoti kryetar i Komisionit,

Të nderuara zonja e zotërinj deputetë të Komisionit,

Do të shprehem vetëm me dy fjalë në lidhje me risitë që sjell kjo paketë e përbashkët, për t’i lënë mundësi edhe relatorit për të dhënë edhe ai rezymenë dhe objeksionet e veta. Projektligji “Për të drejtën e informimit” dhe ndryshimet te projektligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale” janë bazuar në modelet vendeve më të përparuara të Europës perëndimore, si Anglia, Suedia, Gjermania, Spanja etj., si edhe ato të ish-Europës lindore, ku e drejta e informimit tashmë trajtohet paralelisht me mbrojtjen e të dhënave personale. Autoriteti që mbulon mbrojtjen e të drejtës për informim ka në kompetencë dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Në thelb, e drejta e informimit dhe mbrojtja e të dhënave personale janë dy fusha që duhen trajtuar së bashku, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të vendoset një balancë midis tyre dhe privacia e individit mund të mbrohet dhe kur jepet informacion edhe mbi dokumentet zyrtare. Duke u bazuar në nevojën për përmirësimin e kuadrit ligjor të së drejtës për informim, e drejtë që

sanksionohet në Kushtetutë, në nenin 23, Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me fondacionin “Soros” vite më parë, ka hartuar projektligjin “Për të drejtën e informimit”, i cili shfuqizoi një ligj aktual të vitit 1999, që ishte thjesht për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare. Vendimi për hartimin në fakt të një ligji të ri, në vend të amendimit të atij ekzistues, është nisur nga nevoja për të reformim rrënjësor të kuadrit ligjor për të drejtën e informimit në Shqipëri, e cila nuk mund të adresohet vetëm në një ligj amendues.

Projektligji është përgatitur duke pasur parasysh modelet më të mira europiane, por njëkohësisht edhe të vendeve të rajonit me një situatë të përafërt me Shqipërinë, si Kroacia, Maqedonia, Serbia, së fundit, të cilat kanë hartuar ligje mjaft bashkëkohore, në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare që mbulojnë fushën mbi të drejtën e informimit. Për të mos u zgjatur shumë, do t’ju them që projektet kanë këto risi:

Së pari, krijojnë një figurë të re, siç është koordinatori për të drejtën e informimit dhe parashikojnë në mënyrë të shprehur kompetencat e tij.

Së dyti, mbrojnë të drejtën për informim që ka çdo qytetar, pa qenë nevoja në këtë rast të sqarojnë motivet se pse bëhet kjo.

Së treti, rregullojnë, përgatitin dhe miratojnë programe të duhura për këtë transparencë.

Së katërti, rregullojnë njohjen me informacionin e dokumentit zyrtar dhe publik, pra mënyrën se si realizohet kjo.

Së pesti, parashikojnë kufizimin e së drejtës për informim me rastet taksative.

Së gjashti, parashikojnë shkeljet dhe sanksionin administrativ.

Së shtati, rregullojnë kompetencat dhe procedurat për shqyrtimin e ankesave.

Bazuar edhe në relacionet që keni përpara, këto dy projekte kanë kaluar një koordinim dhe bashkëpunim me pothuajse të gjitha institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, vërejtjet e të cilave janë pasqyruar atje ku nuk vinin në kundërshtim me Kushtetutën dhe me mënyrën e trajtimit të gjësë. Me këtë rast, për të eliminuar çdo lloj paqartësie, pasaktësie dhe përplasjeje që shpesh e kemi ndeshur, dua të ofroj qasjen e re që kemi. Të nderuar deputetë, në shoqëritë e përparuara demokratike, sidomos në demokracitë parlamentare, shpesh në jurisprudencat e tyre ndeshet një koncept i cili është munduar të harrohet por që duhet pranuar gjithmonë: është koncepti i fuzionit të pushteteve. Thënë me thjesht, bashkimi apo përzierja e pushteteve në drejtimin e vendit. Zakonisht, fuzioni i pushteteve në demokracitë parlamentare ndodh midis

pushtetit legjislativ dhe pushtetit ekzekutiv, kur një trupë merr pak a shumë pushtete nga të dyja palët, për t'i shërbyer sa më mirë qytetarëve.

Ky është një kontrast, që është i rreptë faktikisht me ndarjen e pushteteve, ose me ndarjen e pastër të pushteteve, por fuzioni i pushteteve sot ekziston më shumë, mos të themi në shumicën e demokracive parlamentare moderne. Sistemi i përzierjes së pushteteve, që ndodh këtu edhe me Komisionerin, është rezultat i një evolucioni politik që ka ndodhur në Europën perëndimore: vjen nga Anglia, faktikisht, ku nisën të reduktojnë kompetencat e monarkut dhe të Dhomës së Lartë, duke ia dhënë Dhomës së Ulët, që faktikisht është Dhoma parlamentare.

Kjo ndodh edhe në përplasjet që shpesh qeverisja - ekzekutivi, parlamenti – ka me pjesën tjetër, që është Presidenti i Republikës. Anashkalohet ky funksion, që në republikat parlamentare është i detyrueshëm. Pa këtë fuzion, nuk ka qeverisje. Nuk ka qeverisje të thjeshtë, nuk ka qeverisje për qytetarët. Avantazhi i këtij bashkimi që kemi bërë, sipas gjithë mbështetësve – nuk besoj se ka vende më të përparuara në Europë se Gjermania, Anglia apo Suedia – e bën më të lehtë, më të thjeshtë dhe më produktiv veprimin qeveritar në realizimin e dy gjërave: të informosh qytetarin për atë që ndodh dhe njëkohësisht të mos e shpërndash kontrollin e këtij informimi të qytetarëve me bllokim të një pushteti tjetër: “janë të dhënat zyrtare”, “nuk mund të hysh në këtë mënyrë” etj. Mënyra se si e kemi trajtuar është edhe kushtetuese. E keni të qartë, në Kushtetutën e re të Republikës së Shqipërisë kemi pasur histori që lidhen me fuzionin e pushteteve. Sot mund të shkelen disa momente. Gjëja e parë është që, nëse ishe deputet, nuk të ndalohej që të ishe edhe anëtar i qeverisë. Kjo krijonte mundësinë e mospërplasjeve midis pjesës së legjislativit me pjesën e gjyqësorit dhe qeverisja punonte si një e tërë, pa krijuar handikape. Këto janë probleme të pushteteve.

Po ju them që është një zgjidhje shumë e mirë. Plotësisht kushtetuese. Plotësisht në bashkëpunim me praktikën dhe kërkesat e ndërkombëtarëve. Mendoj se i bën shumë mirë një gjëje që qe plotësisht e pazgjidhur, që mendohej se do të kontrollohej ndërmjet disa pushteteve të ashtuqajtura kuazi të pavarura, por që nuk zgjidhin asgjë, sepse në fund nuk sanksiononin, nuk dënonin dot, nuk jepnin dot atë që e ka pushteti ekzekutiv. Dhe ngeleshin vetëm në letra si fletërrufe politike apo sociale.

Faleminderit për respektin!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Isaraj!

Të dëgjojmë zonjën Caka, si relatore e projektligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Silva Caka – Faleminderit, zoti kryetar!

Në bazë të kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe të atij të Komisionit të Ligjeve, për periudhën 1 deri më 18 shtator 2014, jam caktuar relatore për këtë projektligj, miratimi i të cilit i nënshtrohet rregullit të përgjithshëm për sa i përket shumicës. Projektligji sjell disa ndryshime, siç tha edhe zoti Isaraj, që në mënyrë të përmbledhur do t’i paraqesim si më poshtë.

Në nenin 1 propozohet ndryshimi i emërimit: nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Në nenin 2 propozohet ndryshimi i titullit: duke u zëvendësuar me “për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit”.

Në nenin 3 propozohet shtimi i kompetencave të tjera të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe në lidhje me mbrojtjen e së drejtës për informim.

Sipas relacionit shoqërues, që ka ardhur nga Këshilli i Ministrave, autoriteti i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është i gatshëm të ushtrojë kompetencat e tij dhe në implementimin e ligjit “Për të Drejtën e Informimit”, pasi ai gëzon një sërë kompetencash, deri në atë vendimmarrëse, si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik. Komisioneri nxjerr udhëzime dhe i boton ato në Fletoren Zyrtare, akte me fuqi detyruese në territorin e vendit për të gjithë sektorët. Për rrjedhojë, do të parashikojë dispozita edhe për mbikëqyrjen e LDI-së. Komisioneri ka informacion të detajuar për çdo kontrollues publik e privat në vend për përpunimin e të dhënave që kryen, që nga mbledhja e tyre, deri në shkatërrimin pas përpunimit të tyre.

Me ndryshimet që pësoi ligji “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, ndër të tjera, ka përfshirë edhe caktimin e personit të ngarkuar në çdo kontrollues. Në fushën e veprimtarisë së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk ka subjekte përjashtimore që nuk i nënshtrohen zbatimit të ligjit “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, por përfshihen të gjitha institucionet publike dhe private, të cilat mbikëqyren, hetohen, kontrollohen dhe dënohen administrativisht. Edhe që, në përsëritje të shkeljeve, kallëzohen edhe pranë organit të prokurorisë.

Në ligjin organik është parashikuar edhe përpunimi i të dhënave për qëllime gazetarie, letrare dhe artistike. Është e dukshme që në të gjithë përpunimin e të dhënave për të arritur këto qëllime, do të përfshihet dhe e drejta e informimit. Për përpunimin e të dhënave në këtë fushë, Komisioneri, në rast të konstatimit të shkeljeve, vendos gjobë e padysim kërkon balancën e argumentuar nga kontrolluesi, media, pikërisht mes asaj se çfarë lejohet dhe çfarë ndalohet.

Për të sjellë disa edhe nga eksperiencat ndërkombëtare, siç u përmend edhe nga zëvendësministri, vende të përparuara si Gjermania, Anglia, Suedia, Spanja, por edhe ato të Europës lindore, edhe sot e trajtojnë edhe të drejtën e informimit krahas mbrojtjes së të dhënave personale. Së fundit, edhe Agjencia e Mbrojtjes së të Dhënave Personale në Malin e Zi, që prej shkurtit të vitit 2013 do të ushtrojë këto dy kompetenca. Gjithashtu, edhe Hungaria, ku autoriteti i saj për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me miratim të parlamentit, u kthye në një organ kushtetues. Në aspektin ligjor, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi. Në aspektin procedural, ai është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në fakt, do të kisha disa çështje për të diskutuar dhe disa pyetje.

Së pari, lidhur me nenin 1 të projektligjit, ku propozohet ndryshimi i titullit të ligjit nga “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” në “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit”, mendojmë se është i panevojshëm, për shkak se e drejta e informimit do të trajtohet në një ligj në vete, paralelisht me këtë. Nëpërmjet këtij projektligji shtohet vetëm një nen, ku synohet shtimi i kompetencave të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në kuadër të së drejtës së informimit.

Pyetja e dytë. Kalimi i një të drejte kushtetuese, siç është e drejta e informimit, nga kompetencë e një organi kushtetues, siç është Avokati i Popullit, në kompetencë të një autoriteti të krijuar me ligj, si Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, çfarë garancish do të sillte për zbatimin më efektiv në praktikë të kësaj të drejte?

Së treti. A ka një detyrim të legjislacionit ndërkombëtar për të krijuar një autoritet mbikëqyrës për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale?

Së katërti. Në vendet me demokraci të re, ku përfshihet aktualisht dhe Shqipëria, Avokatit të Popullit i duhet të mbikëqyrë një gamë shumë të gjerë të drejtash: me këto burime njerëzore dhe me këtë kohë në dispozicion, a do të ishte i mundur implementimi i suksesshëm i të drejtës

së informimit dhe më pas monitorimi i kësaj të drejte, si dhe mbledhja e statistikave nga organet e administratës publike?

Së pesti. Për zbatimin sa më efektiv të një të drejte kushtetuese është e rëndësishme pavarësia e autoritetit që e mbikëqyr. Sa i pavarur është sot Autoriteti i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave dhe a ka ai burime dhe përgjegjësi të mjaftueshme për të përmbushur këtë pozicion?

Së fundmi. Sa ka qenë i suksesshëm institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave në ushtrimin e pozicionit të tij? Sa gjopa janë vënë prej tij në një vit? Sa prej tyre janë lënë në fuqi nga gjykata? Sa janë ekzekutuar dhe sa kanë ndikuar ato në përmirësimin e zbatueshmërisë së ligjit “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Isaraj, për praninë tuaj! Në fakt, ligji i ri që po diskutojmë sot “Për të drejtën e informimit” duhet parë lidhur ngushtë me ndryshimet që po i bëjnë ligjit “Për Komisionerin e të Dhënave Personale” dhe me projektligjin “Për Avokatin e Popullit”, që ne kemi filluar ta diskutojmë në sesionin e kaluar parlamentar dhe që do ta vazhdojmë gjatë kësaj jave.

Projektligji është paraqitur konform rregullave që parashikon Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë dhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Unë nuk po ndalem te dispozitat përkatëse, qoftë të Rregullores, qoftë të Kushtetutës, pasi ato janë në relacion dhe janë standarde, por do të ndalem te qëllimi i projektligjit.

Në fakt, sot që ne po diskutojmë kemi një ligj për të drejtën e informimit mbi dokumentet zyrtare, që është miratuar në vitin 1999, por që nga kjo periudhë, në nivel evropian, por edhe në Shqipëri janë bërë shumë ndryshime të legjislacionit, kemi konventë të Këshillit të Europës dhe shumë rekomandime në fushën e së drejtës së informimit. Gjithashtu, në sesionin e kaluar parlamentar, por edhe në legjislaturën e kaluar, ne kemi miratuar një sërë ligjesh që lidhen në një mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me të drejtën e informimit. Prandaj, unë bie dakord me atë çfarë thuhet në relacionin e qeverisë, që shoqëron projektligjin, se ndryshimet jashtë aq të shumta dhe thelbësore, që e bëjnë të domosdoshme të kemi një ligj të ri.

Nga studimi që i kam bërë projektligjit dhe relacionit, edhe për publikun që na dëgjon, dua të bëj të qarta disa risi që sjellë ligji dhe që kanë interes për të.

Në radhë të parë, nuk ka një komisioner të ri për të drejtën e informimit, por Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale merr një kompetencë ekstra të theksuar dhe emërtimi i tij ndryshon, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Prandaj kjo është arsyeja që ne po ndryshojmë, amendojmë edhe ligjin për Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Risia e dytë e rëndësishme për çdo qytetar është se në çdo institucion të administratës publike krijohet Koordinatori për të Drejtën e Informimit. Pra do të ketë një person nga nëpunësit e administratës civile, nëpunës civil, i cili nuk do të ketë detyrë tjetër, përveçse të informojë qytetarët dhe qytetarët në bazë të këtij ligji nuk do të enden dhe do të qëndrojnë dyerve të institucioneve ditë të tëra për të marrë një informacion, pasi do të ketë një person konkret që do të merret me këtë punë.

E treta, mbrojtja e të drejtës për informim jepet pavarësisht jepen ose jo motivet përse kërkohet informacioni. Pra, askush nuk mund t'i thotë një qytetari “çfarë motivi ke që kërkon këtë informacion”.

Së katërti, është programi i transparencës. Pra, ligji rregullon që çdo institucion duhet të përgatisë programin e transparencës. Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtës së Informimit ka detyrimin të përcaktojë modelet se si do të bëhen programet e transparencës në çdo institucion dhe çfarë duhet të përmbajnë informacionet në faqet e internetit për publikun. Në këtë mënyrë çdo qytetar që ka nevojë të marrë informacion, nuk ka pse të shkojë në dyert e institucioneve, por në ligj përcaktohet konkretisht çfarë duhet të jetë publike dhe të merret pa kërkesë nga qytetarët. Kjo është ndër risitë më të fuqishme, do të thosha, më të rëndësishme të këtij ligji.

Gjithashtu, ka një ndryshim shumë të rëndësishëm lidhur me mënyrën se si mund të merret informacion. Pra sot informacion nuk mund të merret vetëm për dokumente zyrtare, por edhe informacione të tjera që mund të kenë institucionet jo vetëm me shkresë, por edhe në rrugë elektronike, nëpërmjet e-mail-it, çka e lehtëson jashtëzakonisht shumë marrjen e informacionit dhe bënë transparencën e qeverisjes.

Gjithashtu, ligji për herë të parë parashikon në mënyrë eksplicite rastet kur kufizohet e drejta për informim. Në këtë mënyrë ne bëjmë një balancë shumë të mirë midis mbrojtjes së

sekretit shtetëror, të dhënave personale dhe të drejtës për informim. Në ligj parashikohen edhe shkeljet administrative, në rastet kur një qytetari nuk i ofrohet akses në informacionet dhe dënimet ose sanksionet administrative.

Të gjitha këto janë në mënyrë të përmbledhur rrisitë e ligjit, pasi ligji ka edhe disa risi të tjera që kur të diskutojmë nën për nën do të bëhen të qarta për publikun.

Më lejoni, të nderuar kolegë, të bëj me dijë se ky ligj është konsultuar gjerësisht nga qeveria. Është një ndër ligjet më të konsultuara dhe kjo vjen edhe në përgjigjet e shkresave që kryetari i këtij komisioni në muajin qershor i ka adresuar gjithë grupeve të interesit. Pavarësisht konsultimit që bëri qeveria, ne e gjykuam që të konsultojmë edhe disa institucione të tjera, që megjithëse ishin konsultuar në fazën e parë të draftimit të ligjit, që ka kohë që është draftuar, të përfitonin, të jepnin opinionet e tyre pas ligjeve që ne kemi miratuar në sesionin e kaluar parlamentar.

Më lejoni të falënderoj Avokatin e Popullit, organizatat e të drejtave të njeriut, Komitetin e Helsingut, Qendrën për Nisma Ligjore Qytetare, Unionin e Gazetarëve dhe fondacionin “Soros”, i cili përsëri ka dhënë mendimet e tij. Ndërkohë i kemi dërguar kërkesë për të shprehur opinion edhe shumë organizatave të tjera, por ato nuk janë përgjigjur.

Gjithashtu, më lejoni, të nderuar deputetë, të tërheq vëmendjen, por ndërkohë e kam edhe në formë pyetjesh për përfaqësuesit e qeverisë, që gjatë diskutimit të këtij projektligji të shikonim raportin me disa ligje të tjera që tashmë ne i kemi miratuar. Konkretisht: ka një kërkesë të bërë nga një projekt që asiston reformën në luftën kundër korrupsionit në Shqipëri që kërkon të shohë përputhshmërinë e këtij ligji me ligjin “Për deklarimin e pasurive” që ne sapo e kemi amenduar.

E dyta, ne kemi në diskutim Kodin e Procedurave Administrative dhe ky ligj ka lidhje edhe me Kodin e Procedurave Administrative, konkretisht pjesa që flet për shkeljet administrative dhe sanksionet.

Gjithashtu, ne kemi kaluar ligjin “Për ndihmën juridike”. Edhe ky ligj i referohet ligji i referohet ligjit të ndihmës juridike.

Ne kemi kaluar ligjin për publikimet zyrtare. Edhe ky ligj i referohet ligjit të publikimeve zyrtare.

Njëkohësisht kemi në diskutim ligjin “Për Avokatin e Popullit” dhe ligjin e konsultimit publik, në ditët në vazhdim.

Çështjet që do të doja të trajtonim dhe që kanë nevojë të diskutohen dhe të trajtohen lidhen së pari me të drejtën për informim:

Do të ketë të bëjë vetëm me dokumentin zyrtar apo edhe me informacionet që prodhohen dhe mbahen nga institucionet, siç thuhet në ligj?

Do të pranojmë ndryshimin që Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të jetë edhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit, në çfarë raporti?

Si do të jetë bashkëpunimi me Avokatin e Popullit, i cili është një institucion kushtetues dhe në bazë të nenit 134 të Kushtetutës ai ka të drejtë të referojë çështje në Gjykatë Kushtetuese kur palët kanë ankim për shkeljen e së drejtës, të drejtës në përgjithësi dhe të drejtës për informim? Se e drejta për informim është shumë e gjerë dhe prek shumë fusha ku Avokati i Popullit punon, edhe në fushën e policisë, të paraburgimit, në burgje, në administratë publike etj.

Gjithashtu, ia vlen të diskutojmë se në çfarë raporti do të jetë ankimi që do të bëjnë qytetarët te Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, do të jetë ankim i instancës së dytë, pasi ai të ketë ezauruar, siç thotë Kodi i Procedurave Administrative animimin te organi që ka nxjerrë aktin ose organi epror, apo do të shkojë direkt në gjykatë.

Këto janë disa nga çështjet që unë do të kisha nevojë t'i diskutojmë së bashku gjatë diskutimit nen për nen.

Për ta mbyllur, në rast se më lejon edhe zoti kryetar, unë kam dy pyetje:

A është bërë tabela e përputhshmërisë së këtij ligji me direktivat e BE-së dhe nëse e keni gjetur këtë të plotë ose jo?

Meqenëse ju keni paraqitur projektligjin e Avokatit të Popullit dhe ne e kemi diskutuar në parim dhe na ka mbetur ta diskutojmë tani nen për nen, mendoni se ka nevojë që ta rishikojmë edhe këtë pjesë, që lidhet me të drejtën e informimit dhe kalimin e një pjese të kompetencave te Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale?

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Hysi!

Kemi dëgjuar relatorët e dy projektligjeve. Fillimisht zonjën Caka, për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe më pas zonjën Hysi, lidhur me projektligjin “Për të drejtën e informimit”.

Përpara se të bëhen pyetje nga kolegët, do të dëshiroja të dëgjonim komentet që kanë dy institucionet, Zyra për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Avokati i Popullit, për t'u pasuar nga ministria për të dhënë një opinion për çfarë u trajtua nga dy relatorët dhe problematika të mundshme që mund të ngrihen nga dy institucionet e tjera.

Fillimisht Zyra për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisioneri nuk është i pranishëm, sepse nuk është në Shqipëri.

Zonja Shala e ka fjalën.

Anola Shala – Në përputhje me diskutimet e deritanishme dhe me relacionet e propozuesve, unë shumë shkurt dua t'ju informoj lidhur me rëndësinë që kanë dy projektligjet për t'u trajtuar, zbatuar, mbikëqyrur nga e njëjta ombrellë, pra nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Vjen si risi, por tashmë vendet e tjera tashmë e kanë ezauruar këtë pjesë dhe vazhdojnë të inkurajojnë qeveritë për të kaluar të drejtën e informimit mbi dokumentet zyrtare pikërisht pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Rasti i fundit është i Malit të Zi, që në shkurt të vitit 2013 përfshiu edhe të drejtën e informimit mbi dokumentet zyrtare. Edhe ai projekt u parapri nga disa organizma të tjerë të cilët rekomanduan dhe inkurajuan pikërisht që Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Mal të Zi të merrte këtë të drejtë për një arsye jo të thjeshtë, por thelbësore, është kjo agjenci që merret në mënyrë të drejtpërdrejtë me trajtimin sesa mund të jepet informacion dhe se sa mund të kufizohet informacioni. Pra, sa lejohet, sa ndalohet. Për të pasur parasysh këtë balancë, duhet të kemi parasysh edhe pjesën tjetër që është autoriteti i mbrojtjes së të dhënave personale, i cili me konsolidimin dhe eksperiencën e përfutur për sa i përket trajtimit të të dhënave personale, është në gjendje që të kuptojë, madje të mirëkuptojë bërjen e balancës nga të gjitha autoritetet publike në rastin kur japin informacione mbi dokumentet zyrtare.

Duhet të kemi parasysh që informacionet brenda mund të kenë të dhëna personale.

Nuk mund ta bëjë një autoritet tjetër, i cili pa dashur mund të mos njohë ose mund të mos zbatojë parimet për mbrojtjen e të dhënave personale, çka do të thotë nëse do të përhapë informacion, këtë nuk do t'ia lejojë në një moment të caktuar ligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Pra të dyja janë shumë të lidhura të dyja, sepse duke pasur parasysh zbatimin e përpunimit të drejtë dhe të ligjshëm të të dhënave personale do të mbajmë në vëmendje

informacionin që duhet të japim. Pra do të bëjmë kujdes në ruajtjen e privacisë përballë asaj që në fakt ne duhet t’ia transmetojmë publikut.

Nga ana tjetër është shumë e rëndësishme të kemi parasysh edhe faktin që jemi një institucion dhe kemi rol vendimmarrës. Kemi parasysh që ashtu si është parashikuar vendimmarrje për sanksionim me gjoba në ligjin “Për të drejtën e informimit të dokumenteve zyrtare”, është e njëjta situatë e marrë nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave përpara pesë vjetëve. Për analogji, unë do të thosha se edhe në vitin 1999, ishte Avokati i Popullit që kishte kujdesin mbi ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe u krijua një institucion i ri. Pra ligji për mbrojtjen e të dhënave disponohet, administrohet, mbikëqyret, hetohet kontrollohet nga Komisioneri për të Mbrojtjen e të Dhënave.

Për sa i përket progresraporteve të Bashkimit European, vit pas viti, kemi pasur dhe janë lehtësisht të verifikueshme, rezultate pozitive në konsolidimin e autoritetit. Madje rezultate pozitive edhe nga përfundimi i projektit IPA që asistoi për dy vjet e gjysmë. Në të njëjtën kohë i vetmi informacion ose i vetmi identifikim i progresraportit të vitit 2013 kishte të bënte përsëri me publikimin, pra zbatimin e udhëzimit të komisionerit për sa i përket publikimit të vendimeve gjyqësore, që nëse do ta marrim të mirëqenë në këtë formë siç unë e thashë, do të kemi parasysh që pikërisht këtë bëri komisioneri kur doli me udhëzim, sa mund të kemi transparencë dhe sa jo. Pra bëri balancën midis asaj që duhet të identifikohet dhe asaj që nuk duhet të identifikohet, në rastin konkret kur shkelen të drejtat e palëve në procese gjyqësore.

Për sa i përket pyetjes që u shtrua për vendosjen e gjobave, mund t’ju them se në shumicën e rasteve ato janë ekzekutuar vullnetarisht nga kontrolluesit. Pjesa tjetër ende është në proces gjyqësor dhe ndodhet në Gjykatën e Apelit, në shkallë të dytë, mes tyre kemi pranime dhe rrëzime të kërkesave.

Për sa u përket pastaj ankimeve që u diskutua, ndodh e njëjta gjë. Nëse do të jemi përpara faktit se me mbrojtjen e të dhënave personale, kemi një kërkesë që i drejtohet kontrolluesit në këtë rast publik, se duhet të kemi parasysh që ligji për mbrojtjen e të dhënave personale dhe autoriteti i krijuar e shtrin veprimtarinë e tij në të gjithë territorin e vendit dhe nuk bën dallim as nga kontrolluesi publik, as nga ai privat, në këtë rast ne flasim për kontrolluesit publik, pra për autoritetet publike, në këtë këndvështrim do të thosha se të gjitha autoritetet publike, duke pasur parasysh zbatimin e mirë të ligjit “Për të drejtën e informimit”, kanë pasur parasysh pikërisht

hartimin dhe draftimin e këtyre parashikimeve në përputhje me ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Nëse shohim sot ligjin “Për të drejtën e informimit”, do të vëmë re që pikërisht brenda tij janë përthithur dispozita nga ligji “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Aty ku mund të lejohet, në parashikimet ligjore, janë bërë parashikime se kur dhe sigurisht duke e përqasur këtë me pjesën tjetër ku cenohet privatësia dhe nuk mund të lejohet e drejta e informimit.

Unë mbështetës plotësisht atë që u tha deri tani për informacionin e dhënë dhe relacionet dhe besoj se komisioneri me punën e tij kaq vjeçare, duke pasur parasysh edhe rezolutat e Kuvendit nga njëri raport te tjetri, që kanë ardhur duke u përmirësuar, duke u reflektuar në rezultate pozitive, do të jetë aktiv, shumë i gatshëm dhe i përkushtuar për të mbajtur të dyja ligjet nën veprimtarinë e tij kontrolluese, inspektuese etj.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Të dëgjojmë dhe përfaqësuesit e institucionit të Avokatit të Popullit.

Po zonja Gjonaj.

Etilda Gjonaj –Faleminderit, për mundësinë e pjesëmarrjes në këtë mbledhje! Avokati i Popullit do të kishte dashur që të ishte vetë prezent, por ai ndodhet në një mision jashtë. Meqenëse njoftimi u bë një ditë më përpara, e kishte të pamundur për të qenë prezent këtu. Në këtë kuadër do të donim që të kishte shtyrje të diskutimit qoftë dhe të çështjes në parim, nëse do të ishte e mundur. Në rast të kundërt pastaj ne jemi këtu për të dhënë objeksionet tona lidhur me projektligjin. Të dy ne si komisionerë, zoti Shkëmbi dhe unë, do të japim disa nga komentet tona për sa i përket këtij projektligji.

Fatmir Xhafaj - Mund të vazhdoni, se komisioni nuk e kurdis dot orën sipas orës së Avokatit të Popullit, se ka ndodhur dhe herë tjetër kjo histori. Sa herë që janë jashtë shtetit titullarët e institucioneve, ne duhet të shtyjme mbledhjen e komisionit. Nuk ka sens. Ju jeni dy komisionerë dhe ju ka zgjedhur Kuvendi me votim në sallë. Keni mandatin e Kuvendit të dy dhe mund ta përfaqësoni institucionin. Pastaj kur të jetë nen për nen mund të vijë dhe Avokati i Popullit bashkë me komisionerin e mbrojtjes së të dhënave personale i cili gjithashtu është jashtë shtetit.

Po, zonjë.

Etilda Gjonaj– Institucioni i Avokati i Popullit, i cili po shpreh mendimet sot për projektligjin “Për të drejtën e informimit”, është në mënyrë kategorike kundër këtij projektligji që ka të bëjë me përcaktimin e regjimit juridik të një të drejte themelore të njeriut, i cili prek dhe cenon seriozisht kompetencat e institucionit të Avokatit të Popullit për disa aspekte të cilat do t’i rendisim si më poshtë.

Nisur nga përcaktimet ligjore të bëra në projektligj dhe dimensionin kushtetues të veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit evidentojmë se mënyra e prezantimit të këtij projektligji është shqetësuese dhe mendojmë se shkel parimet bazë të funksionimit të sistemit institucional dhe substancial të shtetit të së drejtës. Në mënyrë të padiskutueshme në këta 13 vjet institucioni i Avokatit të Popullit ka pasur një veprimtari dhe aktivitet shumë të gjerë jo vetëm në trajtimin e ankesave që lidhen me objekte dhe fusha të ndryshme, por ajo që është kryesore dhe thelbësore është e drejta e informimit. Ashtu siç na ka njohur ligji ne për të qenë garant në zbatimin e këtij ligji, “Për të drejtën e informimit” të vitit 1999, ashtu kemi trajtuar të gjitha këto ankesa që na janë drejtuar për të drejtën e informimit, por jo vetëm. Institucioni i Avokatit të Popullit në një vit merr mesatarisht 4 mijë e 500 ankesa, të cilat, pavarësisht se u përkasin fushave të ndryshme, janë në mënyrë të lidhur ngushtë me të drejtën e informimit, ku administrata shtetërore në të shumtën e rasteve nuk jep një informacion fare të thjeshtë, nuk jep një dokumentacion, por që pa diskutim lidhet me një të drejtë të caktuar.

Gjatë gjithë këtyre viteve Avokati i Popullit jo vetëm që ka shërbyer për të trajtuar dhe për të rivendosur në vend të drejtat e shkelura të qytetarëve, për sa i përket të drejtës së informimit, por njëkohësisht ka lobuar dhe ka sensibilizuar lidhur me zbatimin dhe garantimin e ligjit e të drejtës për informimin. Bazuar në këtë rol sinjifikativ në fushën e mbrojtjes të të drejtave të njeriut Avokati i Popullit mbetet një nga institucionet më të vlerësuara dhe nga organizatat ndërkombëtare lidhur me zbatimin e kësaj të drejte, ashtu si dhe me një sërë të drejtash të tjera. Vëmë re se në asnjë rresht të relacionit të këtij projektligji nuk citohet fakti se përse heqja e kësaj kompetence Avokatit të Popullit është kaq e domosdoshme dhe për se është zgjedhur modeli ku një komisioner i mbrojtjes së të drejtave të të dhënave personale duhet të jetë garant për të drejtën e informimit. E para.

E dyta, një problem i dukshëm në projektligjin “Për të drejtën e informimit” për dokumentet zyrtare është rënia e nivelit të mbrojtjes së të drejtës nga niveli i institucioneve me qëndrueshmëri të lartë si Avokati i Popullit, si një institucion kushtetues, në nivelin e

institucioneve të pavarura të krijuara me ligj. Të mos harrojmë se e drejta për informim është një e drejtë kushtetuese dhe si e drejtë kushtetuese meriton që të mbrohet nga një institucion kushtetues. Mbrojtja e së drejtës për informim është e lidhur pazgjidhshmërisht me kompetencën e Avokatit të Popullit për mbrojtjen e promovimin e të drejtave të njeriut në vend.

Hartuesit e projektligjit nuk kanë kuptuar faktin se veprimtaria e përditshme e institucionit të Avokatit të Popullit lidhet në mënyrë integrale me të drejtën e informimit dhe në thelb është realizimi vital i të gjithë të drejtës për informim. E themi këtë për faktin se jo vetëm ankesat që ne përmendëm që trajton Avokati i Popullit brenda një viti, por edhe ankesa të veçanta vetëm për të drejtën e informimit Avokati i Popullit i ka trajtuar dhe ka dhënë rekomandimet konkrete drejtuar institucioneve përkatëse. Ky projektligj mendojmë se tenton heqjen e kompetencave të institucionit të Avokatit të Popullit duke synuar kështu në mënyrë të drejtpërdrejtë dobësimin e këtij institucioni të parashikuar shprehimisht në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Mendojmë se heqja e kompetencave njëkohësisht prish balancat kushtetuese dhe deformon qëllimin e mekanizmave të krijuara nga Kushtetuta, veçanërisht roli i Avokatit të Popullit si një garanci juridiksionale për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore. Edhe kalimi i kompetencës së një institucioni tjetër cenon haptas në Kushtetutë misionin e Avokatit të Popullit, zonja Hysi e përmendi, faktin se krijon pengesa serioze të këtij institucioni kushtetues për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese.

Tentativa për të pakësuar kompetencat e Avokatit të Popullit dhe për t'ia kaluar këto kompetenca institucioneve të pavarura mendojmë se është denigruese për punën, aktivitetin profesional dhe të mirëvlerësuar të institucionit të Avokatit të Popullit. Gjithashtu, është një tendencë e kundërt me trendin evropian, i cili synon që kompetencat e së njëjtës fushë të shpërndara midis institucioneve të ndryshme t'ia kthejë dhe t'ia japë një institucioni të vetëm. Ashtu siç ka praktika evropiane, që u përmendën, ku mendohet se i bashkojmë në një institucion të përbashkët dhe të dhënat personale, dhe të drejtën e informimit, ka edhe tendenca dhe praktika të cilat i centralizojnë në një institucion kushtetues. Kompetenca e kujdestarisë së zbatimit të ligjit “Për të drejtën e informimit” për dokumente zyrtarë mendojmë se duhet t'i mbetet Avokatit të Popullit, i cili jo vetëm ka eksperiencën 13-vjeçare, por ka kapacitetet njerëzore, infrastrukturore, si dhe ligjore për këtë qëllim. Mendojmë se ajo që nevojitet është mbështetja e këtij institucioni me një bazë më të mirë legislative në këtë fushë, për të mundësuar eficiencë

maksimale për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtës për informim dhe realisht pa asnjë kosto shtesë.

Nëpunësit e Institucionit të Avokatit të Popullit tashmë janë të trajnuar, të mirëinformuar mbi të drejtën e informimit, kanë një praktikë të konsoliduar, për sa i përket trajtimit të tyre. Për këtë arsye mendojmë se duhet të mbetet kompetencë e Avokatit të Popullit, për më tepër që përbën një vështirësi të madhe në zbatimin funksional të detyrave tona për trajtimin e ankesave të qytetarëve, pasi ashtu siç e përmendëm çdo ankesë që vjen ka të bëjë me të drejtën e informimit. Kjo do të na vërë ne përpara vështirësisë për të trajtuar ankesat e qytetarëve.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zonja Saliu!

Nuk i keni dakordësuar pikëpamjet, apo jeni në fusha të ndryshme?

Po, zoti Shkëmbi.

Arben Shkëmbi – Faleminderit, zoti kryetar!

Në të njëjtën linjë jam dhe unë. Unë do të ndalesha vetëm në dy momente, pasi problematika u trajtua nga parafolësit në mënyrë të detajuar. Dhe ne do të sillnim të njëjtat argumente në favor të pozicionimit për të qenë ne kujdestarë në ligjin “Për të drejtën e informimit”, ashtu sikurse u paraqit dhe në relacion në kahun tjetër. Dy janë momentet që mendoj unë që janë thelbësore.

E para, zbret në një shkallë më poshtë mbikëqyrja e ligjit “Për të drejtën e informimit” nga institucion kushtetues në institucion të krijuar me ligj.

Dhe e dyta, trendi është orientim edhe nga institucionet dhe organizmat që na asistojnë, institucionet ndërkombëtare, që rritjen e gamës së kompetencave të Avokatit të Popullit me këtë ligj ne na ngushtohet hapësira në veprimtarinë e punës tonë të përditshme. Për këto shkaqe ne jemi kundër në lidhje me paraqitjen e këtij projektligji. Unë do të shtoja se duhet të ishte paraqitur bashkë me këtë paketë dhe ligji për ndryshimet në ligjin e Avokatit të Popullit.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Besoj se u dëgjuan të dyja institucionet mjaftueshëm. Para se të bëjë një ndërhyrje ministria në reagime se çfarë u tha, a ka pyetje që t’i përmbledhë?

Unë kam një pyetje. Kjo kompetencë i hiqet Avokatit të Popullit, dhe ku? Sot e ka me ligj Avokati i Popullit këtë të drejtë. A ka ndonjë akt që ia heq këtë kompetencë? E kam përpara dhe ligjin “Për Avokatin e Popullit” që propozoi zoti Shkëmbi, të kalojë me procedurë të

përsheptuar. Ku është shqetësimi juaj? E ka dhe komisionerja apo ju nuk e keni më? Unë nuk po arrij dot ta kuptoj.

Po, zonjë.

Etilda Gjonaj– Vetë ligji e heq kompetencën e Avokatit të Popullit për të qenë garant i ligjit “Për të drejtën e informimit”. Në këtë mes ne do ta kemi shumë të vështirë nesër në rast se një ankues do të vijë të ankohet për një çështje të caktuar e cila jo detyrimisht lidhet drejtpërdrejt me të drejtën e informimit, por në vetvete ka të bëjë me marrjen, me pasjen e një informacioni ose dokumenti që e kanë institucionet shtetërore. Me këtë projektligj, siç është sot, ne e kemi të vështirë për të shkuar te institucionet shtetërore dhe ta kërkojmë këtë dokument, në kuadër të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut. Kjo do ta bëjë, sepse është vetë mënyra e ndërtimit të projektligjit, është vetë kompetenca që i jepet komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale, e drejta e informimit. Në rast se do ta ketë ky komisioner, do të jetë shumë e vështirë që Avokati i Popullit të veprojë.

Fatmir Xhafaj – Çfarë ju pengon ju të paraqiteni dhe të thoni? Kjo është një e drejtë që jua jep ligji. Ju jeni dhe institucion kushtetues, për më tepër, dhe e keni marrë me ligj këtë dhe e gëzoni në ligj. Nuk jua heq ligji sot. Ku dëmtoheni ju se pse e kanë dhe këta.

Etilda Gjonaj – Që në momentin që thuhet se për kompetencat për zbatimin e ligjit “Për të drejtën e informimit” garanti merret komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale, absolutisht që këtu fillon cenimi ynë. Sepse nuk mundet paralelisht që dy institucione, siç është institucioni kushtetues i Avokatit të Popullit dhe një institucion tjetër i krijuar me ligj të kenë të drejtën e informimit për ta monitoruar ose për të qenë garant i zbatimit të këtij ligji. Pra, janë të dyja momentet.

E para, që ulet niveli i mbrojtjes, ashtu siç e thamë, nga një e drejtë kushtetuese që do t’i përkasë një institucioni kushtetues ulet në një institucion tjetër i cili është i caktuar me ligj.

Fatmir Xhafaj -Ku hiqet? E gëzon Avokati i Popullit. Në ligjin e Avokatit të Popullit nuk thuhet se nuk e ka më këtë kompetencë. Vazhdon të jetë ajo kompetencë.

Etilda Gjonaj -Fakti që në projektligjin “Për të drejtën e informimit” thuhet se do të jetë komisioneri për mbrojtjen e të dhënave personale garant i këtij ligji, atëherë që këtu fillojnë dhe cenohen kompetencat tona.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Ka pyetje të tjera nga kolegët?

Po, zoti Subashi.

Armando Subashi – Në fakt kam një pyetje për ministrinë duke qenë se është iniciatorja e dy projekteve dhe në vijim të asaj pyetje që bëtë ju, zoti kryetar.

Në konceptin e hartuesve të këtyre drafteve të ministrisë Avokati i Popullit në gjithë veprimtarinë e vet, në gjithë ato kompetenca që i njeh edhe Kushtetuta, edhe ligji, në rastin kur do të ketë përpara një ankesë konkrete, ku mund të pretendohet mohimi i së drejtës për informim, dhe pse mund të ketë kaluar instancat administrative që i takojnë komisionerit, a mundet që në objektin e këtij shqyrtimi të kësaj ankese të kontrollojë edhe aktivitetin e vetë komisionerit? Pra, se si komisioneri, jo vetëm institucioni përkatës shtetëror, e ka përmbushur të drejtën e informimit publik, por edhe vetë komisioneri për ato detyra që i kanë ngarkuar ose mund t'i ngarkojë ky ligj a mundet që ta kontrollojë dhe atë, nëse i ka plotësuar detyrimet ligjore apo jo ndaj subjektit. Pastaj të dalë me konkluzionet, rekomandimet, propozimet e veta, apo të mund ta gjykoj që të ushtrojë dhe të drejtën që i njeh Kushtetuta që, për çështje konkrete për rastin konkret mund të shkojë edhe deri në Gjykatë Kushtetuese, sepse e ka këtë të drejtë Avokati i Popullit.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit!

Ka pyetje të tjera? Po, zoti Isaraj. Do të doja që të bënit një përmbledhje, nëse e shikoni të arsyeshme, të komenteve që u bënë nga zyra e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale nga Avokati i Popullit, si dhe për pyetjet që u adresuan drejtpërdrejt.

Arben Isaraj – Pak a shumë do t'u përgjigjem të gjitha shqetësimeve që u ngritën, që nga relatorët dhe deri te palët e interesuara.

Së pari, ashtu si ju, edhe ne kemi përpara opinionin e Ministrisë së Integritetit në lidhje me çka ndodh sot në Bashkimin Europian ose në vendet tona partnere, në vendet rreth e rrotull rajonit me këtë fushë dhe si zgjidhet kjo fushë e veprimtarisë. Shembujt që kemi sjellë janë të shumtë, por nuk ka nevojë të krahasojmë tani ne Gjermaninë, Anglinë me raste sporadike të cilat vazhdojnë të mbijetojnë në ato demokraci, që vazhdojnë të jenë në tranzicion pa zgjidhur asnjëherë problemin. Ajo që dua të them unë, që zgjidh shqetësimin e zonjës Hysi, është se tashmë ka edhe praktika të vendeve europiane, që janë shumë të reja, siç është Hungaria, që duke mbetur të pakënaqura nga zgjidhja tjetër, kanë arritur që komisionerin ta ngrenë në nivel kushtetues dhe kjo mund të jetë një iniciativë kushtetuese.

Hungaria sot e ka ngritur në nivel kushtetues. Pra, ka një qasje tjetër, dhe unë nuk po i hyj kësaj gjeje, edhe komisioneri zgjidhet nga parlamenti. Ajo që dua të them, që ishte edhe një shqetësim, nuk është vetëm e drejta për informim e drejtë themelore e shtetasve në Shqipëri. I bie që për çdo të drejtë të kishim nga një Avokat të Popullit.

Problematika është kjo, në qoftë se e shikojmë kështu, që merret vetëm me informimin, do të thotë që Avokati i Popullit është tellall publik. Pra, për çdo gjë që nuk informohet duhet të thotë “rekomandon”. Në bazë të Kushtetutës, ka të drejtë të kontrollojë çdo institucion, që shkel këto të drejta dhe parime, por rekomandon. Kthehet dot në ekzekutiv? Në asnjë mënyrë nuk kthehet. Populli, që kur ka lindur e drejta, nuk vë dot gjoba, populli nuk vendos sanksione. Ai voton dhe të rrëzon nga pushteti. Sanksionet i vë pjesa ekzekutive. Pra, ky fuzion që thamë në fillim krijon këtë mundësi: se cili do të vendos gjobat, nëse shkelet kjo e drejtë legjitime e qytetarëve? I vë dot Avokati i Popullit? Asnjëherë. Rekomandon dhe nëse deri dje në ligjin “Për informimin publik”, në nenin e fundit, unë nuk jam marr shumë me këtë çështje, por kam qenë në një grup pune, thuhet se ai që e ndjek zbatimin e këtij ligji është ky institucion. Kam kërkuar në arkivat e Kuvendit gjatë gjithë kësaj kohe që të shikoja një rekomandim ose një sugjerim se çfarë ndodhte me këtë ligj. Çfarë pakënaqësish kishim ne për ta rregulluar ligjin përfundimisht? Nuk kam gjetur gjë me thënë të drejtën. Mund të jetë mangësia e arkivës apo e ndonjë gjëje tjetër dhe si grup pune i përbashkët, bashkë me produktet ndërkombëtare, kemi arritur në këtë zgjidhje, e cila i bashkon të gjitha problemet dhe ndihmon qytetarin në këtë rast. Pra, ata që shkelin ligjin duhet të paguajnë diçka apo të dënohen. Pra, duhet të ketë sanksione. Këtu vjen edhe pandëshkueshmëria. Pra e shkelnim, nuk e informonim qytetarin. Cili do të mbante përgjegjësi? Rekomandimi do të mbajë përgjegjësi?

Kjo ishte zgjidhja jonë dhe mendoj se është zgjidhja e duhur, ligjore dhe kushtetuese. Nuk e kuptojmë si mund të shkelen kompetencat kushtetuese të një organi tjetër. Ajo mbetet dhe këta kanë të drejtë të kërkojnë llogari për shumë gjëra, të cilat lidhen edhe me këtë ligj, me zbatimin e tij, dhe të rekomandojnë pastaj në institucione, që buron pushteti në Shqipëri, siç është parlamenti për të ndryshuar edhe ligjet, për të hequr edhe kompetencën atje ku nuk ecën puna.

Në përgjithësi ky është opinionin ynë në lidhje me problemet teknike të zgjidhjeve gjatë diskutimit nen për nen të kemi edhe gjëra të tjera. Këtu kemi edhe dy zonjat përgjegjëse direkt

teknikisht në lidhje me këtë iniciativë, edhe me teknikën legjislativë, të cilat mund t'u japim përgjigje nëse keni pyetje të tjera që ju shqetësojnë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit, zoti Isaraj!

Zonja Jorgaqi, urdhëroni!

Edlira Jorgaqi – Faleminderit, zoti kryetar!

Shkurtimisht dua të sqaroj disa momente të rëndësishme që dëgjova nga kolegët përfaqësues të Avokatit të Popullit, në lidhje me faktin që, e thënë shprehimisht prej tyre, ky projektligj prish balancën kushtetuese apo cenon apo i heq kompetencat Avokatit të Popullit si institucion kushtetues. Kjo nuk është e vërtetë. Ajo që shprehimisht parashikon Kushtetuta në lidhje me Avokatin e Popullit është e parashikuar në nenin 60, paragrafi i parë, ku thuhet shprehimisht: “Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individit nga veprimet apo mosveprime të paligjshme dhe të parregullta të organeve të administratës publike”, i cituar shprehimisht, neni 60, paragrafi i parë i Kushtetutës, gjë e cila duke zbritur në hierarkinë e normave ligjore është transpozuar në të njëjtën mënyrë në ligjin “Për Avokatin e Popullit”. Ajo që i është dhënë shprehimisht Avokatit të Popullit është në ligjin “Për të drejtën e informimit”, nr. 8503 i vitit 1999 dhe konkretisht është neni 18, “Kompetenca e Avokatit të Popullit titulli i neni është i tillë dhe thuhet shprehimisht se Avokati i Popullit kujdeset për zbatimin e këtij ligji”.

Pra, për të qenë korrekt me atë që është shkruar në ligj, më duhet të theksoj edhe një herë se kjo kompetencë që ju thoni, se Avokati i Popullit është kujdestari i ligjit për të drejtën e informimit i është dhënë me ligjin “Për mbrojtjen për të drejtën e informimit”, dhe jo me Kushtetutë, Kushtetuta është ajo që citova, i është dhënë me ligj dhe po me ligj po preket dhe në asnjë rast nuk mund të thuhet se ka cenim të Kushtetutës apo të hierarkisë së normave ligjore. Është shkruar e zeza mbi të bardhë.

Ajo për të cilën ne kemi ardhur këtu dhe kemi bërë këtë lloj propozimi lidhet në thelb me mënyrën si ka funksionuar regjimi i të drejtës së informimit të publikut. Nga ju dëgjuam konkretisht se keni trajtuar rreth 4500 ankesa dhe në fund të ditës cili është rezultati i kontrollit të këtyre ankesave që ju keni bërë?

Në fund të ditës, cili është roli që ka Avokati i Popullit të parashikuar shprehimisht në Kushtetutë dhe në ligj? Pra, është ajo që tha edhe zoti zëvendësministër pak më parë që Avokati i Popullit në fund rekomandon.

Ajo që ne synojmë për ta bërë efektiv, funksional regjimin e së drejtës së informimit është që ta kalojmë te një institucion vendimmarrës sikurse është një institucion i pavarur, komisioneri për mbrojtjen e të dhënave dhe për të qenë tepër bindës për këtë, përveçse referimit të ligjeve konkrete edhe në Kushtetutë, në vetë projektligjin, që ndoshta ju ka shpëtuar pa ju lexuar, “Për të drejtën e informimit” në nenin 24, paragrafi 7 thuhet shprehimisht se: “Procedurat administrative parashikuar në këtë nen lidhen me ankimin, nuk cenojnë kompetencat e Avokatit të Popullit lidhur me mbikëqyrjen dhe zbatimin e të drejtave civile sipas ligjit nr. 8454 “Për Avokatin e Popullit.”

Në përgjigje të pyetjes që bëri zoti Subashi, funksionet dhe detyrat e Avokatit të Popullit do të vazhdojnë të jenë ashtu siç janë, nuk cenohen dhe nuk preken. Siç i kanë konsideruar deri tani do të vazhdojë t’i konsiderojnë.

Faleminderit!

Armando Subashi – Pyetja ime është kjo: në konceptin tuaj si hartues të këtij drafti Avokati i Popullit a mund të kontrollojë edhe komisionerin? Sepse mund të jetë një rast i tillë që një shtetas ka ankesë ndaj iks organi administrativ. Avokati konstaton se çështja ka ndjekur gjithë këto shkallë dhe deri te komisioneri, edhe komisioneri mund të ketë gjykuar që: “Po, kjo ka të bëjë me të dhënat personale dhe kjo e drejtë nuk mund të jepet etj., etj”, dhe në fund shkon dhe Avokati i Popullit. A mund të jetë edhe veprimtaria e komisionerit objekt i kontrollit të punës nga Avokati i Popullit dhe në fund të dalë me rekomandime edhe për të?

Fatmir Xhafaj – Zoti Isaraj, urdhëroni!

Arben Isaraj – Dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërdrejtë nga institucioni kushtetues, kjo është e padiskutueshme.

E dyta, argumentuam se çfarë shkruhet në ligj. Tani, në qoftë se deri dje Avokati i Popullit e kontrollonte këtë institucion dhe në qoftë se ai shkelte ligjin në lidhje me të dhënat personale, kush e pengon që, sipas ligjit që ka apo detyrimit kushtetues të kontrollit të administratës publike, si sillet ajo me qytetarin, të kontrollojë edhe veprimtarinë sipas ligjit të këtij institucioni? Besoj se nuk kërkon më tepër...

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Zonja Etilda Gjonaj, urdhëroni!

Etilda Gjonaj – Dua të bëj vetëm një koment të shkurtër. Kur flasim për prishjen e balancave kushtetuese, bëjmë fjalë që kemi një të drejtë kushtetuese që zbatimi i saj të garantohet nga një institucion kushtetues. Këtu e kisha fjalën për balancat kushtetuese.

Për sa i përket pjesës, meqenëse është parë që ndoshta do të ishte më mirë të vendoseshin disa gjopa për të respektuar më mirë ligjin, atëherë në çfarë vendi të relacionit del që të drejtat në Shqipëri janë përmirësuar, sepse janë vendosur më shumë gjopa? Ose sa është respektuar ligji për të drejtat për të dhënat personale, sepse janë vendosur më shumë gjopa, për të mos folur pastaj për vjeljen e gjobave apo për të ardhur te pjesa e relacionit që mbajti zonja Caka.

Për më tepër, Avokati i Popullit jo vetëm që rekomandon, por propozon edhe marrjen e masave për shkelësit, të cilët mund të shkelin ligjin për të drejtën e informimit. Pra, nuk është vetëm që rekomandon. Merr edhe masa ose le të themi rekomandon marrjen e masave për këta persona që shkelin ligjin.

Në këtë rast momenti që cenohet një e drejtë dhe jepet kompetencë një institucioni tjetër, siç është komisioneri, atëherë në rast se ne nesër do të na vijë një ankesë për të drejtën e informimit ne do t'i themi: Zotëri i dashur, ne nuk mund ta trajtojmë ankesën, sepse ekziston ligji i cili ia ka dhënë komisionerit në kompetencë”, ose në qoftë se do të shkojmë te institucioni do t'i themi: Institucion i dashur, ju lutem jepni një informacion për sa i përket këtij personi...

Fatmri Xhafaj – Më falni, zonja Gjonaj, kur ju vijnë persona që kanë probleme me strehimin, çfarë u thoni?

Etilda Gjonaj – Pa diskutim, ne i trajtojmë, por po flasim për një ligj që ka të bëjë me të drejtën e informimit. Nuk po flasim me të drejtat le të themi, që kanë bashkitë. Flasim gjithmonë për pjesën që ne jemi garant për të parë si respektohen.

Fatmir Xhafaj – Dakord. Ju kërkoi ndjesë për ndërprerjen.

Etilda Gjonaj – Jo kaq ishte edhe komenti.

Fatmir Xhafaj - Dakord. Besoj se pak a shumë është e qartë. Relatorja ka ndonjë koment shtesë?

Urdhëroni!

Vasilika Hysi – Në fakt, unë nuk jam dakord me atë që thotë përfaqësuesja e Avokatit të Popullit, që prishet balanca kushtetuese, sepse Avokati i Popullit në bazë të nenit 60, paragrafi i parë, ka të drejtë të monitorojë. I vetmi problem që lind me miratimin e këtij ligji është që

Avokati i Popullit duhet të shikojë profilin dhe mënyrën si do të bashkëpunojë me komisionerin për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, sikurse është edhe rasti i komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi. Është e njëjta.

E dyta, në ka gjë të mirë që ka bërë ky ligj është pikërisht parashikimi i llojit të shkeljeve në fushën e të drejtës së informimit dhe i sanksioneve, sepse deri më sot askush nuk e përcakton nëse është shkelur e drejta për informim ose jo. Bazuar në praktikën e Gjykatës së Strasburgut besoj se për rregullimin që i bën nenit 18 që ne nuk do ta diskutojmë nen për nen, parashikon çdo lloj shqetësimi që ka ngritur publiku dhe nuk është njësoj të bësh rekomandim dhe të japësh dënim administrativ, madje edhe masa disiplinore, sepse projektligji parashikon edhe masa disiplinore edhe dënimet me gjobë.

Gjithashtu, një argument i tretë është që Avokati i Popullit, përsëri në bazë të nenit 134 të Kushtetutës, shkronja “dh”, ka të drejtë të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, por unë shtrova pyetjen në relacionin tim dhe prandaj ne si komision kemi rënë dakord që ta diskutojmë nen për nen në ditët në vazhdim, duhet të rishikojmë të gjitha ligjet që kemi miratuar, meqenëse ky është paraqitur në muajin qershor si projekt dhe ne po e diskutojmë tani në shtator. Ndërkohë në muajin korrik kemi miratuar një sërë ligjesh, që citohen në këtë projektligj, ne nuk duam të bëjmë gabime, t’i bëjmë dispozitat që të bien ndesh me njëra-tjetrën, por do t’i shikojmë një për një.

Avokatit të Popullit edhe në rishikimet që ne do të bëjmë nuk i mohohet e drejta kushtetuese për t’iu referuar Gjykatës kushtetuese.

Për ta mbyllur, është shumë e domosdoshme të shikohet qasja si do të bashkëpunojë tashmë Avokati i Popullit nëse parlamenti e miraton këtë ligj me komisionerin e mbrojtjes së të dhënave personale për të përcaktuar fokusin e punës së tyre, por është Avokati i Popullit përgjegjës që do të monitorojë respektimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Në vazhdim të diskutimeve të tjera, zoti Vasili, urdhëroni!

Petrit Vasili – Unë mendoj se në fund të këtij diskutimi, për të mos shpërqendruar vëmendjen e publikut, meqë kemi edhe mundësinë që media na ndjek live, duhet të jemi më të lumtur se një ditë më parë, që kufijtë e informimit për publikun morën një zhvillim të ri. Të gjithë bashkë duhet të qëndrojmë fort dhe të komentojmë këtë standard.

Kemi një rregullim shumë më të fortë. Pra, një publik që informohet me një standard nga më të lartët dhe madje këtu mund të them se demokracia jonë ka ecur ndoshta edhe më përpara, por vetë publiku ndoshta nuk ishte përgatitur për një demokraci të tillë, por ia kemi dhënë dhe nuk ka ndonjë gjë të keqe, sepse transparenca e madhe mbron. Për mua çështja e raportit si monitoron dhe cili është raporti i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve është një çështje që nuk na takon ne ta zgjidhim këtu. Kjo është pjesa rutinë që institucionet në bazë të legjislacionit gjejnë urat dhe mënyrat e bashkëpunimit. Le të qëndrojmë te ky standard dhe në parim propozoj që të mbetemi këtu dhe të përcjellim këtë mesazh që kemi një publik, i cili mund të jetë më i qetë se më parë, sepse e ka këtë të drejtë, madje të garantuar, qoftë edhe me sanksione përkatëse. Nëse kjo e drejtë u mungon dhe më tutje, në diskutimet nen për nen ne kemi mundësi të korrigjojmë ndonjë gjë, që të jetë sa më e ekuilibruar.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Vasili!

Besoj se ndajmë të njëjtin mendim me kolegun Vasili dhe me iniciuesit e projektit.

Ka ndonjë koment tjetër? Nuk ka.

Atëherë e mbyllim për sot mbledhjen e komisionit. Shqyrtimi i këtyre dy projekteve do të vazhdojë ditën e hënë në orën 10:00.

Faleminderit!

Ju uroj gjithë të mirat dhe punë të mbarë!

